



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 11 Maj 2023

Nr: 499

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 367 ID, NGA KOALICIONI PËR  
REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA NDAJ KRYETARËVE  
TË DISA BASHKIVE, PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE, NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E  
QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 11 Maj 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjet administrative me:

**KËRKUES:** Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)

**SUBJEKT:** Z. Agron Malaj, Kryetari i Bashkisë Mat;  
Zj. Alma Hoxha, Kryetari i Bashkisë Përmet;  
Z. Artur Bushi, Kryetari i Bashkisë Krujë;  
Z. Arif Tafani, Kryetari i Bashkisë Belsh;  
Z. Ervin Demo, Kryetari i Bashkisë Berat;  
Z. Andis Salla, Kryetari i Bashkisë Cërrik;  
Zj. Majlinda Qilimi, Kryetari i Bashkisë Delvinë;  
Z. Eduard Duro, Kryetari i Bashkisë Devoll;  
Z. Rahim Spahiu, Kryetari i Bashkisë Dibër;  
Z. Fredi Kokoneshi, Kryetari i Bashkisë Divjakë;  
Z. Dhimitraq Toli, Kryetari i Bashkisë Dropull;  
Zj. Emiriana Sako, Kryetari i Bashkisë Durrës;  
Z. Gentian Llatja, Kryetari i Bashkisë Elbasan;  
Z. Armando Subashi, Kryetari i Bashkisë Fier;  
Z. Flamur Golemi, Kryetari i Bashkisë Gjirokastër;  
Z. Blerim Sherra, Kryetari i Bashkisë Vorë;  
Z. Edison Memolla, Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë;  
Z. Elton Arbana, Kryetari i Bashkisë Shijak;

Z. Erion Isai, Kryetari i Bashkisë Kolonjë;  
Z. Erion Veliaj, Kryetari i Bashkisë Tiranë;  
Zj. Eriselda Sefa, Kryetari i Bashkisë Lushnjë;  
Z. Adriatik Mema, Kryetari i Bashkisë Skrapar.

**OBJEKT:** Shqyrtimi administrativ ndaj kryetarëve të disa bashkive, për shkelje administrative, për postime, ripostime dhe përdorim hashtag në faqen e rrjetit social "Facebook"

**BAZA LIGJORE:** Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", pika 2, neneve 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

### **KONSTATOJ:**

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) ka depozituar, denoncime për të cilat denoncuesi pretendon se disa kryetar bashkish kanë postuar apo ripostuar publikime me përmbajtje partiake në faqet zyrtare të rrjetit të tyre social "Facebbok", të cilat përbëjnë përdorim të burimeve publike.

Denoncimi është administruar, nëpërmjet raportit të KRIIK, të datës 2 Maj 2023, "Për gjetjet dhe rekomandimet për javën 21- 27 Prill 2023".

Neni 19, pika 1, shkronja "dh", "f" dhe "n" e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për t'u nisur hetimi administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, "Për kundravajtjet administrative", kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Në vijim të procedurës administrative, filloi shqyrtimi administrativ, duke verifikuar provat si dhe duke kërkuar informacion në lidhje me publikimet e postuara apo ripostimiet me përmbajtje elektorale, slogane dhe # hashtag.

Denoncuesi ka paraqitur pretendime si më poshtë vijon:

**Denoncimi regjistruar me nr. 367 ID, ndaj kryetarëve të bashkive**, me kërkes KRIIK, ku pretendohet si më poshtë vijon:

*“Me aktivitetin e hapjes së fushatës elektorale nga Partia Socialiste, në datën 11 prill 2023, kjo e fundit bëri publike edhe sloganin e fushatës elektorale për zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Konkretisht, slogani i fushatës #VetëmPërpara #KurrëMëMbrapa.*

*KRIIK ka vërejtur që këto slogane, shoqërojnë thuajse çdo postim, pavarësisht se ato janë me natyrë institucionale, në faqet zyrtare në rrjetin social Facebook të Kryeministrit, Ministrave, Deputetëve, Kryetarëve të Bashkive, etj., të cilët kanë llogari aktive në rrjetet sociale. Këto sloganë, të konvertuara dhe përdorura edhe si **hashtag-e lidhen dhe identifikojnë drejtpërsëdrejt Subjektin Zgjedhor “Partia Socialiste”**.*

*Postime të shoqëruara me përdorimin e hashtag-eve të sipërpërmendura gjenden në faqet zyrtare të kryetarëve të bashkive:*

*Të gjitha rastet e postimeve me përmbajtje partiake në faqet zyrtare të kryetarëve të tyre, të detajuara me link-et dhe printscreen-et përkatëse, gjenden bashkëlidhur në raport. 22 Faqe Zyrtare të Kryetarëve të Bashkive janë:*

- Faqja zyrtare e kryetarit të bashkisë Mat, z. Agron Malaj;
- Faqja zyrtare e kryetares së bashkisë Përmet, znj. Alma Hoxha;
- Faqja zyrtare e kryetarit të bashkisë Krujë, z. Artur Bushi;
- Faqja zyrtare e kryetarit të bashkisë Belsh, z. Arif Tafani;
- Faqja zyrtare e kryetarit të bashkisë Berat, z. Ervin Demo;
- Faqja zyrtare e kryetarit të bashkisë Cërrik, z. Andis Salla;
- Faqja zyrtare e kryetares së bashkisë Delvinë, znj. Majlinda Qilimi;
- Faqja zyrtare e kryetarit të bashkisë Devoll, z. Eduard Duro;
- Faqja zyrtare e kryetarit të bashkisë Dibër, z. Rahim Spahiu;
- Faqja zyrtare e kryetarit të bashkisë Divjakë, z. Fredi Kokoneshi;
- Faqja zyrtare e kryetarit të bashkisë Dropull, z. Dhimitraq Toli;
- Faqja zyrtare e kryetares së bashkisë Durres, znj. Emiriana Sako;
- Faqja zyrtare e kryetarit të bashkisë Elbasan, z. Gentian Llatja;
- Faqja zyrtare e kryetarit të bashkisë Fier, z. Armando Subashi;

- Faqja zyrtare e kryetarit të bashkisë Gjirokastrë, z. Flamur Golemi;
- Faqja zyrtare e kryetarit të bashkisë Vorë, z. Blerim Sherra;
- Faqja zyrtare e kryetarit të bashkisë Rrogozhinë, z. Edison Memolla;
- Faqja zyrtare e kryetarit të bashkisë Shijak, z. Elton Arbana;
- Faqja zyrtare e kryetarit të bashkisë Kolonjë, z. Erion Isai;
- Faqja zyrtare e kryetarit të bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj;
- Faqja zyrtare e kryetares së bashkisë Lushnjë, znj. Eriselda Sefa;
- Faqja zyrtare e kryetarit të bashkisë Skrapar, z. Adriatik Mema.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ, pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të tyre, provohet se të gjitha postimet dhe ripostimet në faqet zyrtare të rrjetit social “Facebook”, të institucioneve subjekt i këtij denoncimi, janë përdorur hashtag dhe slogane me përmbajtje elektorale.

Nga verifikimet paraprake sa i përket faqeve personale të kryetarëve të bashkive, objekt shqyrtimi **theksojmë** se postimet në llogaritë personale në “facebook” të tyre, nuk mund të përbëjnë prova të mjaftueshme për të provuar lidhjen midis postimit dhe shkeljes administrative. Kryetarët e bashkive gëzojnë edhe karakterin politik dhe si i tillë mund të postojë në faqen personale mesazhe politike, promovim të nismave politike, festimi i arritjeve politike apo çdo lloj mesazhi tjetër politik. Marrëdhëniet personale apo postimet në llogaritë personale në facebook të tyre, dalin jashtë fushës së zbatimit dhe objekti të rregullimit të Kodit Zgjedhor dhe akteve normative në fuqi dhe si të tilla nuk mund të trajtohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Parashikimi i ndalimeve për sa i përket këtyre postimeve me natyrë politike interferon në liritë themelore siç janë liria për t’u shprehur si dhe liritë dhe të drejtat politike.

Për pasojë duhet të pushohet shqyrtimi administrativ për kryetarët e bashkisë dhe ministrat objekt denoncimi.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2, nenin 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

#### **V E N D O S:**

1. Moskonstatimin e shkeljes dhe pushimin e hetimit administrative ndaj:

Data: 11 Maj 2023

Nr: 499  
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 367 ID, për shkelje administrative”

- z. Agron Malaj, kryetar për bashkinë Mat;
  - zj. Alma Hoxha, kryetar për bashkinë Përmet;
  - z. Artur Bushi, kryetar për bashkinë Krujë;
  - z. Arif Tafani, kryetar për bashkinë Belsh;
  - z. Ervin Demo, kryetar për bashkinë Berat;
  - z. Andis Salla, kryetar për bashkinë Cërrik;
  - zj. Majlinda Qilimi, kryetar për bashkinë Delvinë;
  - z. Eduard Duro, kryetar për bashkinë Devoll;
  - z. Rahim Spahiu, kryetar për bashkinë Dibër;
  - z. Fredi Kokoneshi kryetar për bashkinë Divjakë;
  - z. Dhimitraq Toli, kryetar për bashkinë Dropull;
  - zj. Emiriana Sako, kryetar për bashkinë Durrës;
  - z. Gentian Llatja, kryetar për bashkinë Elbasan;
  - z. Armando Subashi, kryetar për bashkinë Fier;
  - z. Flamur Golemi, kryetar për bashkinë Gjirokastër;
  - z. Blerim Sherra, kryetar për bashkinë Vorë;
  - z. Edison Memolla, kryetar i bashkisë Rrogozhinë;
  - z. Elton Arbana, kryetar për bashkinë Shijak;
  - z. Erion Isai, kryetar për bashkinë Kolonjë;
  - z. Erion Veliaj, kryetar për bashkinë Tiranë;
  - zj. Eriselda Sefa, kryetar për bashkinë Lushnjë;
  - z. Adriatik Mema, kryetari për bashkinë Skrapar.
2. Urdhërimin e fshirjes së menjëhershme nga faqet zyrtare të rrjetit social “Facebook”, të çdo postimi apo ripostimi në të cilat janë përdorur hashtag me përmbajtje elektorale.
  3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
  4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
  5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Kopje: 4

Afati i ruajtjes: 5 vjet

Punoi:

I.Horanlliu \_\_\_\_\_

M.Koja \_\_\_\_\_

A. Lamçe \_\_\_\_\_

Y.Merkaj \_\_\_\_\_

Data: 11 Maj 2023

Nr: 499

Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 367 ID, për shkelje administrative”

Data: 11 Maj 2023

Nr: 499  
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 367 ID, për shkelje administrative”